

VENDIM
Nr. 485, datë 16.7.2014

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 289, DATË 17.5.2006, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E AGJENCISË SË LEGALIZIMIT,
URBANIZIMIT DHE INTEGRIMIT TË ZONAVE/NDËRTIMEVE INFORMALE (ALUIZNI)”, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4 e 46, të ligjit nr. 9482, datë 16.2.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban dhe Turizmit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 289, datë 17.5.2006, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

a) Pikat 2 dhe 3 ndryshohen si më poshtë vijon:

“2. ALUIZNI ka Drejtorinë e Përgjithshme në Tiranë dhe drejtori varësie në çdo qendër qarku. Përgjithësisht, në Tiranë ALUIZNI, ka katër drejtori varësie.

3. ALUIZNI përmbush objektivat, kryen detyrat dhe ushtron përgjegjësitë e përcaktuara në ligjin nr. 9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, dhe ligjin nr. 10186, datë 5.11.2009, “Për rregullimin e pronësisë në truallin shtetëror në zonat me përparësi turizmin”, të ndryshuar.”.

b) Pika 5 ndryshohet si më poshtë vijon:

“5. ALUIZNI drejtohet nga drejtori i përgjithshëm dhe dy zëvendësdirjtorë.”.

c) Pika 9 ndryshohet si më poshtë vijon:

“9. Ministri i Zhvillimit Urban dhe Turizmit miraton rregulloren e brendshme të funksionimit të ALUIZN-it.”.

Ngarkohen Ministri i Zhvillimit Urban dhe Turizmit dhe Drejtori i Përgjithshëm i ALUIZN-it, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama